



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 1611 Prot

Tiranë, më 26.1.2021

Lënda: Njoftim për shpallje konkurimi të brendshëm (me procedurën e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë brenda sistemit doganor)

Drejtuar: **DREJTORIVE NË D.P.DOGANAVE
DEGËVE DOGANORE**
Për publikim: **DREJTORISË SË BURIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME JASHTË DHE
INTERGRIMIT EUROPIAN**

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në zbatim të pikave 5 dhe 6 të nenit 15 të ligjit nr. 102/2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, të Kreut II dhe III të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 921 datë 29.12.2014 "Për Personelin e Administratës Doganore", i ndryshuar, Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese", i ndryshuar shpall konkurimin e brendshëm për pozicionin:

Kryetar, Dega Doganore Tiranë.

Kategoria A, Kategoria e pagës III- a (një vend)

Përshkrim përgjithësues për pozicionin:

Siguron administrimin e efektshëm, drejton, bashkërendon punën dhe mbikëqyr veprimtarinë e kryer në degë Doganore.

Ushton funksionet dhe kompetencat sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për këtë pozicion, si dhe funksionet e përgjegjësitë që i delegohen këtij posti.

Administron Degën Doganore në kryerjen e funksioneve të saj parësore, kryesisht atë të mbledhjes së të ardhurave si dhe lidhur me misionin e saj mbrojtës në përputhje me ligjin.

Mbrojtja e interesave financiarë dhe mjedisorë të Republikës së Shqipërisë nga tregtia e padrejtë dhe e paligjshme, duke mbështetur ndërkohë aktivitetin e ligjshëm të biznesit;

Garantimi i sigurisë e i mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë dhe i banorëve të saj, si dhe mbrojtjes së mjedisit e, kur është e nevojshme, në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet e tjera; Mbatja e balancës së duhur ndërmjet kontrolleve doganore dhe lehtësimit të tregtisë së ligjshme.

Kandidatët që konkurojnë për këtë vend pune duhet të plotësojnë këto kritere:

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Adresa: Autostrada Tiranë-Durrës, Km 1, Rr.Industriale,Pajtoni Center,kati 5
www.dogana.gov.al

Kriteret minimale:

- Të ketë një vlerësim pozitiv apo një certifikatë/vërtetim për një kualifikim të posaçëm profesional, që i përshtatet vendit të ri të punës
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi
- Të përmbushë kriteret e veçanta në shpalljen për konkurim
- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar

Kriteret e veçanta:

- Të zotërojnë diplomë të nivelit të parë dhe “Master Shkencor” ose diploma të barazvlefshme me të sipas legjislacionit të arsimit të lartë në shkencat Ekonomike dhe Juridike, Politeknike.
- Të ketë mbi 3 vitë eksperiencë pune në pozicion e kategorisë të ulët drejtues në Administratën Doganore.

Për të qenë pjesëmarrës në konkurrim, personat e interesuar duhet të dorëzojnë dokumentacionin e mëposhtëm brenda datës 04.01.2021 pranë Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore:

1. Kërkesë për marrje pjesë në testim
2. Curriculum Vitae
3. Rekomandim nga eprori direkt.

Fusha e Njohurive:

1. Ligji nr. 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
2. Ligji nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar
3. Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
4. Ligji nr. 9367 datë 07.04.2005 “Për Parandalimin e Konfliktit të Interesave në ushtrimin e funksioneve Publike”, i ndryshuar.
5. Ligji nr.9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” i ndryshuar.
6. Urdhëri nr. 123, datë 09.11.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhërin nr. 90, datë 18.11.2014 “Për miratimin e Kodit të Etikës në Shërbimin Doganor Shqiptar”.
7. Urdheri nr.146, datë 07.05.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Rregullores së Brendshme Mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorise se Pergjithshme të Doganave dhe të Rregullores së Brendshme, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Degëve Doganore”.

Procedura e përzgjedhjes do të bëhet në mbështetje të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, vendimit nr. 921, datë 29.12.2014, “Për personelin e administratës doganore”, i ndryshuar.

Pozicioni më sipër, i ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet në të njëjtën kohë!

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015, të Departamentit të Administratës Publike "www.dap.gov.al".

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Genti Gazheli

